



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 28.
Prishtinë, më 7 shtator 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Adem Hajdaraj, Armend Zemaj, Kolë Berisha, Ibrahim Makolli, Selvije Halimi dhe Mufera Şinik.

Munguan: Adem Salihaj dhe Vladimir Todorović.

Të pranishëm: Lumni Rama – OSBE, Denny Filiks – OSBE, Lorik Bajrami – "Çohu", Besnik Boletini – "Bota Sot", Merita Mustafa - KDI, Lumnije Murati -YPRK, Reshit Gashi – NDI, Jetulla Aliu e Mentor Borovci – Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Visar Krasniqi – Kuvendi Kosovës.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

Rendi ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27 korrikut 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit kundër korrupsionit;
5. Shqyrtimi i propozimit të Institutit Gjyqësor për anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit;
6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - I përshëndeti të pranishmit, përfaqësuesit e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe të atyre që e monitorojnë punën e Komisionit. E përshëndeti Mufera Şinikun, e cila është anëtare e re e Komisionit në vend të Džezair Muratit, i uroi mirëseardhje dhe propozoi të fillohet me rendin e ditës.

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27 korrikut 2009

Kryetari i pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje rreth procesverbalit. Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Armend Zemaj – Propozoi të formohet një nënkomision, sepse nëse fillohet nen për nen do të merrte shumë kohë dhe të përshtaten rekomandimet e propozuara të dëgjimeve publike, të përfaqësuesve të EULEX-it, të Komisionit Evropian, të grupeve të interesit dhe të shoqërisë civile. Në këtë mënyrë do të punohet më efektivisht.

Kryetari kërkoi nga anëtarët e Komisionit të propozonin cilët do të jenë pjesëtarë të grupit.

Bajram Kosumi – Propozoi që Armend Zemaj të jetë kryesues i nënkomisionit.

Ishte konstatim i përgjithshëm të formohet një nënkomision me këtë përbërje: Armend Zemaj - kryesues i nënkomisionit, Bajram Kosumi dhe Ramadan Gashi, që deri me 22 shtator të përgatitin amendamente për Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe t'ia paraqesin Komisionit për miratim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit kundër korrupsionit

Kryetari - Propozoi që edhe për Projektligjin kundër korrupsionit të formohet një nënkomision, në mënyrë që të punohet më shpejt.

Komisioni zgjodhi Ibrahim Makollin kryesues të nënkomisionit, Kolë Berishën dhe Adem Hajdarajn, që po ashtu më 22 shtator të përgatitin amendamente për Projektligjin kundër korrupsionit.

5. Shqyrtimi i propozimit të Institutit Gjyqësor për anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit

Kryetari - I njoftoi anëtarët për propozimet e Institutit Gjyqësor dhe propozoi t'i rekomandohen Kuvendit.

Meqë nuk pati vërejtje, propozimet e Institutit Gjyqësor për anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit do t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në një nga seancat e radhës, me arsyetimin për propozimin nga radhët e minoriteteve.

6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur

Komisioni vendosi që më 10 shtator 2009 në orën 13:00 të mbahet një takim për përfundimin e Raportit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur. Në të do të ftohen edhe përfaqësues të institucioneve të rëndësishme për t'i shqyrtuar propozimet dhe rekomandimet që do të procedohen për Kuvend.

7. Të ndryshme

Shkresa e Avokatit të Popullit nr. 284/2009

Komisioni do t'i dërgojë informatë Avokatit të Popullit lidhur me veprimet që mori Komisioni, dhe Komisioni do t'i rekomandojë Kuvendit të debatohet në një të një nga seancat e radhës për shqetësimet për kandidatët e propozuar.

Shqyrtimi i bazës juridike të projektligjeve

Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të projektligjeve:

Të Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,
Të Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit,
Të Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara,
Të Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik,
Të Projektligjit për tatimin në të ardhurat vetjake.

Komisioni vlerësoi se projektligjet kanë bazë juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

E hartoi stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni